



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	03.02.2017
Referencë	11-344/1
Për :	Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Krustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-JANAR

DREJTORATI I INSPEKTORATIT

Gjatë muajit Janar kemi hasur në 15 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pranë qendrës së regjistrimit të bizneseve ARBK-së. Gjithashtu kemi pasur 15 biznese pa pranime teknik të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjienike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit tek Inspektoret e Tregut.

Në bashkëpunim me Inspektoret e ATK-së të divizionit të lojërave të fatit kemi rihapur një kazino pasi që i ka plotësuar kushtet për të ushtruar veprimtarin ekonomike, kemi shqyrtuar një ankesë të konsumatorit i cili mendonte se ju ka bo një e pa drejt rreth blerjes së një produkti, ku kemi inspektuar biznesin dhe e kemi zgjidhur ankesën e konsumatorit.

Janë inspektuar marketet ushqimore si në qytet edhe nëpër fshatra në aspektin higjienik, afatëshmërin e mallit, kushtet e ruajtjes së mallit ku gjatë inspektimit është gjetur mall me afat të skaduar i cili mall është asgjësuar në vend. Vlera e mallit të asgjësuar është 143.81 €.

Është bërë inspektimi i një gypi të dëmtuar të ujësjellësit në fsh. Gadime e Epërme, ku është urdhëruar kompania Kur-Prishtina, NJOU- Lipjan për rregullimin e atijë gypi.

Janë inspektuar mishtoret, marketet dhe disa biznese në lidhje me hedhjen e eshtrave dhe mbeturinave, ku me procesverbal janë urdhëruar që të bëjnë kontrate me kompanisë përkatëse për dorëzimin dhe bartjen e tyre.

Është inspektuar në bazë të kërkesave të palëve dhe planit tonë nëpër fshatra të ndryshme dhe në qytet të cilat kërkesa kishin të bëjnë me ndotjen e mjedisit në përgjithësi. Është bërë një fletëparaqitje për një biznes për shkak të mos respektimit të urdhëresës së dhënë .

Gjatë këtij muaji është bërë inspektimi i të gjithë transportuesve të udhëtareve si auto-taksit dhe kompanitë e autobusëve, është kontrolluar se mos po e ushtrojnë veprimtarin e transportit të udhëtareve në mënyrë ilegale si dhe janë bërë disa pika kontrolli në qytetin e Lipjanit për këtë dukuri. Po ashtu edhe në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari“ në Vrellë në bashkëpunim me policin kufitare, kemi hulumtuar taxit ilegal me qëllim të ndërprerjes së aktiviteti ilegal si dhe largimin e shitësve ambulantiv.

Po ashtu gjatë këtij muaji janë inspektuar marketet ushqimore për produkte me prejardhje bimore. Në disa markete ushqimore janë larguar nga shitja pemë dhe perime si rezultat i dëmtimeve fizike dhe nga temperaturat e ulta.

Për të gjitha parregullsitë është dhen urdhër me procesverbale për evitimin e tyre, për çdo shkelje është vepruar komfor ligjeve në fuqi.

Për kundër temperaturave të ulëta investitorët veç kanë filluar të kryejnë disa punë përgatitore për ndërtim për këtë vitë, janë inspektuar disa objekte të cilat kanë qenë vazhde e punimeve të vitit paraprak, mirëpo kemi hasë edhe në një objekt ekonomik i cili ka tentu të ndërtoj pa leje ndërtimi, ku i janë ndërpre punimet dhe janë marr masat ligjore për ndalim të punimeve.

Të dhënat statistikore më të hollësishme janë të paraqitura në tabelën e më poshtme:

Pasqyra tabelare e punës për muajin -JANAR

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Inspektime për orar të punës	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Përqime sanitare	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktvendime- ndalesa, urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Të hyra nga pranimet teknike	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim për farëra, plehradhe pesticide	Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike	Mallë me afat të skaduar
Biznesit	436	38	3	1		95			70			6	71	122	125€				30	143.81€
Ambientit	248	34		1					125				1	84			3			
Bujqësisë	115	13				29			49				7				5	12		
Ndërtimtarisë	138	5		1					103			3	1	25						
Trafikut	215	11				57			26	56	6			31			28			
Sanitar	210	22		2	84	44			43	4				4		7				143.81€
Gjithsejtë	1362	123	3	5	84	225			416	4	56	15	80	266	125€	7	36	12	30	143.81€